



Prishtine, data: 01.07.2021

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Ne baze te Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, ne lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 4757 dt. 21.12.2018 për mos pagesën e rentës ndaj: **“Thaçi Transport” Sh.p.k** me nr.të biznesit 70344913, me adresë; Jabllanicë, Pejë, merr këtë:

A K T V E N D I M


1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtrësive për **“Thaçi Transport” Sh.p.k** me nr.të biznesit 70344913, me adresë; Jabllanicë, Pejë, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

A r s y e t i m

Ndaj **“Thaçi Transport” Sh.p.k** me nr.të biznesit 70344913, me adresë; Jabllanicë, Pejë, KPMM ka lëshuar aktin administrativ nr. 4757 dt. 21.12.2018.

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt.21.12.2018 dhe me dt.18.03.2021 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .


Ramiz Krasniqi
Drejtor
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale





KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE (KPM), në pajtim me nenin 48.49.50 dhe 51 te Rregullores Nr. 2005/3 Mbi Minierat dhe Mineralet ne Kosove dhe tani ne me nenin 50 dhe 53 të Ligjit për Miniera dhe Minerale (LMM) nr. 03/L-163 si dhe nenit 31 të Ligjit nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin të LMM-së, ndaj ndërmarrjes “Thaçi Transport” Sh.p.k. aplikacioni 180/1, licenca 541/KPMM/2006, nr. i biznesit 70344913 me adresë Jabllanicë-Pejë, pronar Sami Thaqi (mob. 044295701) në procedurë administrative me datë 17/12/2018, nxjerr këtë:

AKTVENDIMI PËR MOS PAGESË TË RENTËS MINERARE

NJOFTIM PER DESHTIM

1. Për vitet 2006, 2007 dhe 2008 ndërmarrja ka mbet pa kryer obligimit e taniemës për shumën 15.705.84€.
2. Në pajtim me nenin 48.49.50 dhe 51 te Rregullores Nr. 2005/3 Mbi Minierat dhe Mineralet ne Kosove si dhe tani ne përputhje me nenin 50 dhe 53 të LMM-së nr. 03/L-163 si dhe nenit 31 të Ligjit nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin të LMM-së, ndërmarrja mbetet e detyruar që shumën e taniemës prej 15.705.84€ të paguaj në këtë xhirrollogari 1000430070005950.
3. Pala ka 15 ditë afat nga data e plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi që të kryejë pagesën e shumës së përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit.

ARSYETIM

Ndërmarrja “Thaçi Transport” Sh.p.k. nuk iu është përmbajtur kushteve të parapara në licencën Nr. 541/KPMM/2006 e cila ka pasur afat deri me datën 27.07.2010 dhe ne përputhje me te drejtat dhe detyrimet ne pajtim me nenin 33 te Rregullores Nr. 2005/3 Mbi Minierat dhe Mineralet ne Kosove .

Detajet e obligimeve te pa raportuara te pa paguara i keni si ne vijim

Ndërmarrja	Afati pageses	Periudha	Viti	Deklaruar	Interesi	Bilanci
Thaçi Transport	31.12.2006	1234	2006	4,193.29	0.00	4,193.29
Thaçi Transport	31.12.2007	1234	2007	7,861.30	0.00	7,861.30
Thaçi Transport	31.12.2009	1234	2008	3,651.25	0.00	3,651.25
Totali				15,705.84	-	15,705.84

Sipas nenit 50 të LMM-së nr. 03/L-163 KPM-ja është organ përgjegjës për vlerësimin dhe arkëtimin e rentave minerare. Duke u mbështetur në kushtet e parapara në LMM-në

ndërmarrja është i obliguar që në KPMM për çdo tremujor të sjell dëshmi me shkrim se renta minerare është paguar në shumën dhe mënyrën e paraparë.

Sipas nenit 53 të këtij Ligji Ndërmarrja për shkak të mos pagesës së rentës i ndalohet që të shes ose tjetërsoj mineralet ose prodhimet derisa të gjitha rentat minerare të jenë paguar ose të arrihet marrëveshje e pranueshme për KPMM-në për pagimin e rentave minerare.

Në rast se ky obligim nuk përmbushet brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të këtij aktvendimi, KPMM do të ndërmarre veprime në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit me nr.04/L-139 të Procedurës Përmbartimore.


Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ky akt administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit nga Drejtori i KPMM-së.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njohimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit Shqyrtues për Ankesa të KPMM-së.

Aktvendimi i dërgohet:

- Arkivit të KPMM-së,
- Departamentit të Financave
- Palës.



Ramiz Krasniqi

Drejtor

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale